

**Përfaqësuesit e KLSH morën pjesë në takimin vjetor të Grupit të Punës të EUROSAT-t për Auditimin Mjedisor (WGEA), i zhvilluar në Baku, Azerbajxhan, në datat 3-4 tetor 2024, i organizuar nga Dhoma e Llogarive, me temë: “Ngjarjet ekstreme të motit dhe strategjitë e gatishmërisë”**

EUROSAT është një organizatë e pavarur, jopolitike e krijuar për të nxitur bashkëpunimin dhe për të nxitur shkëmbimin e ideve, përvojave dhe teknikave midis institucioneve supreme të auditimit (SAI) mbi auditimin qeveritar. Si një nga grupet e tij të punës, Grupi i Punës EUROSAT për Auditimin Mjedisor (WGEA), e përfaqëson këtë frymë dhe synon të promovojë bashkëpunimin e bazuar në integritetin, komunikimin e hapur, si dhe përsosmërinë profesionale në auditimin mjedisor.

Auditimi mjedisor, në parim, nuk është i ndryshëm nga qasja e auditimit e praktikuar nga SAI-t dhe mund të përfshijë të gjitha llojet e auditimit. Në këtë kontekst, vëmendja e auditimit mund t'i kushtohet zbulimit të aktiveve dhe detyrimeve mjedisore, përputhshmërisë me legjislacionin dhe konventat kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe masave të vendosura nga subjekti i audituar për të nxitur ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin, duke promovuar kështu parimin e qëndrueshmërisë.

EUROSAT WGEA u krijua zyrtarisht me vendimin e Kongresit të 4-të të EUROSAT-t të mbajtur në vitin 1999. Qëllimi kryesor i grupit është të promovojë dhe mbështesë bashkëpunimin profesional dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojës.

Tema e takimit vjetor ishin ngjarjet ekstreme të motit, strategjitë e gatishmërisë. Të gjithë duhet të informohen se cilat fatkeqësi dhe rreziqe mund të ndikojnë në zonën e tyre më të afërt, si të reagojnë dhe ku të shkojnë në rast evakuimi dhe të marrin një alarm urgjence në kohë reale.

Në këtë takim morrën pjesë 72 përfaqësues të organeve supreme të auditimit, të 34 shteteve, ku ndër to ishte pjesëmarrëse edhe Shqipëria.

Hapja e takimit u zhvillua me një vizitë në Rrugën e Nderit në Baku, Azerbajxhan, e cila është një varrezë publike dhe memorial, për të nderuar personalitetet e famshme të Azerbajxhanit dhe emigrantëve të lidhur me të, duke përfshirë disa presidentë, shkencëtarë dhe artistë.

Fjalimin e hapjes e zhvilluan Z.Marian Banas, Kryetar i EWGEA, President i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë; Z.Vugar Gulmammadov, Kryetari i Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit dhe Z.Matanyahu Englman, Auditor i Përgjithshëm i Izraelit me anë të një videomesazhi.

EWGEA zhvilloi 6 prezantime online dhe 14 prezantime në power point të prezantuara nga përfaqësues të SAI-ve dhe ECA-s që ishin prezent në takim. Disa nga temat e prezantuara ishin si më poshtë:

1. Tema “Shumë ujë” e prezantuar nga përfaqësues të SAI-t të Belgjikës
2. Tema “Reagimi dhe pasojat mjedisore të fatkeqësive natyrore ose ngjarjeve ekstreme të motit” e prezantuar nga përfaqësues të SAI-t të Republikës Çeke

3. Tema “Gatishmëria, si të vlerësohet përmbushja e objektivave të elasticitetit ndaj fatkeqësive natyrore “ e prezantuar nga përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Auditorëve

4. Tema “Vlerësimi i rreziqeve klimatike” e prezantuar nga përfaqësues të Gjykatës Evropiane e Audituesve

Në ditën e dytë të takimit, u zhvilluan edhe diskutime ndërmjet anëtarëve që morën pjesë, mbi situatën që ishte në vendin e tyre, në lidhje me temën e trajtuar, auditimet që ishin kryer nga institucioni që përfaqësonin, në lidhje me sfidat dhe problemet e ndeshura dhe planet e SAI-t përkatës për auditimet/vlerësimet e reja mbi trajtimin e kësaj teme në të ardhmen e afërt, duke shkëmbyer përvojat e duke shprehur rekomandime në lidhje me gatishmërinë e auditimit për fatkeqësitë dhe emergjencat, si dhe duke sugjeruar zgjidhjet e tyre.



Në këtë takim, KLSH-ja u përfaqësua nga audituesit zj. Olisa Foto dhe z. Bush Bushaj.